

## E ardhmja është IA! Raiffeisen Bank prezanton inovacionet për GenZ në

### Universitetin e Elbasanit

Në kuadër të projektit LAIA, i cili synon integrimin e Inteligjencës Artificiale në mjediset akademike dhe profesionale, në Fakultetin e Biznesit dhe i Drejtësisë u organizua një workshop ndërveprues me përfaqësues të Raiffeisen Bank. Ky aktivitet, pjesë e ciklit të workshopeve dhe takimeve të organizuara në bashkëpunim të ngushtë me Bordin Këshillimor të Biznesit, bëri bashkë studentët, personelin akademik dhe ekspertët e industrisë për të diskutuar mbi sfidat e reja teknologjike.

Nën temën "Marketingu Digjital në Raiffeisen Bank: Zhvillimi i Aplikacioneve për GenZ", fokus të veçantë iu kushtua transformimit të industrisë financiare përmes teknologjive të bazuara në Inteligjencën Artificiale. Gjatë takimit u prezantua Raiffeisen Youth, aplikacioni i parë i këtij lloji që shfrytëzon inovacionin për t'iu përgjigjur nevojave dinamike të gjeneratës së re. Përgjatë prezantimit, Znj. Vjola Mato dhe Z. Endri Pano ndanë ekspertizën e tyre mbi rritjen e efektivitetit përmes mjeteve digjitale, duke u ofruar pjesëmarrësve një perspektivë praktike dhe vlerë të shtuar përmes diskutimeve interaktive.



